fondiBESA

2019

RAPORT VJETOR

Përmbajtja

MESAZH NGA DREJTORI EKZEKUTIV 5

MJEDISI MAKROEKONOMIK DHE ZHVILLIMET KRYESORE NË SISTEMIN FINANCIAR SHQIPTAR 8

SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA 9

ARRITJE 2019 11

PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT KRYESORE AFAT -MESME 2020-2021-2022 12

ZHVILLIMI INSTITUCIONAL 13

MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE 14

BILANCI 16

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE 17

PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË 18

PASQYRA E NDRYSHIMIT TË KAPITALIT 20

MENAXHIMI I RREZIKUT NË FONDIN BESA 21

FITIMI - KAPITALI I AKSIONARËVE 22

PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE 23

PROJEKTE 31

RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR 34

STRUKTURA ORGANIZATIVE 36

HISTORI SUKSESI 37

PARTNERËT 39

Raportin Vjetor 2019 mund ta gjeni edhe në faqen web të Fondit Besa www.fondibesa.com
Për informacione të mëtejshme: Fondi BESA, Rruga “Dritan Hoxha”, Tiranë, Telefon: +355 42253841/2 Fax: +355 42253836
Email: mfi@besa.org.al Website: www.fondibesa.com

Në shërbim të klientëve dhe partneri i tyre drejt zhvillimit

Pas rreth 26 vitesh aktivitet të suksesshëm, përballë sfidave, të cilat e kanë çuar Fondin BESA përpara, sot ne jemi institucioni më i madh mikrofinanciar në vend. Që nga fillimi i aktivitetit e deri tani, sistematikisht kemi qenë përkrah klientëve tanë duke i mbështetur me kredi për zhvillimin e biznesit, kemi zgjeruar aktivitetin dhe kemi hedhur në treg produkte dhe shërbime, të cilat përmbushin nevojat e individëve dhe bizneseve për financim.

Produkte dhe shërbim më i mirë për klientët tanë në rrugën e tyre drejt zhvillimit - kjo është motoja që e udhëheq Fondin Besa Sh. A.

Marrëdhënia e besimit me klientët - aseti ynë!

Çdo ditë, që nga viti 1994, ne kemi qenë të përkushtuar për ndërtimin e marrëdhënieve të besimit reciprok me klientët dhe kemi arritur rezultate të shkëlqyera. Suksesi i biznesit tonë matet me numrin e klientëve që rikthehen për të marrë kredi tek ne, tregues i cili rezulton në nivelin 79%.

Fondi BESA vendos klientin në qendër të aktivitetit të tij dhe kjo shprehet në të gjitha produktet që ofrojmë, të cilat janë të hartuara me kujdes për t'ju përshtatur kërkesave të tregut tonë të synuar, si dhe në zgjerimin e rrjetit të degëve për të qenë sa më pranë klientëve dhe nevojave të tyre.

Fondi BESA mundohet të kuptojë klientët, të analizojë segmentet e ndryshme të tregut për të kuptuar se për çfarë kanë nevojë, në mënyrë që të përshtatë aspekte të ndryshme të ofertës së tij me këtë kërkesë (kohëzgjatja, lloji i produktit të kredisë, frekuenca e shlyerje, çmimi etj.)

Ne punojmë për zgjerimin e aktivitetit nëpërmjet rritjes së numrit të klientëve, rritjes së numrit të zyrave dhe rritjes së stafit tonë. Fondi BESA përpiqet të ndjekë zhvillimin e klientëve nëpërmjet zgjerimit të gamës së produkteve dhe shërbimeve duke u ofruar atyre zgjidhje financiare optimale.

Çdo vit, Fondi BESA mbështet mijëra klientë dhe biznese të vogla dhe të mesme që luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në procesin e zhvillimit ekonomik të vendit.

Ne mundohemi që produktet dhe shërbimet tona të jenë lehtësisht të kuptueshme dhe të arritshme për klientët. Ne besojmë se mënyra më e mirë për të bërë biznes me ta është t'i dëgjojmë dhe të kuptojmë çfarë kërkon të arrijë tregu ynë dhe çfarë kërkon nga ne. Duke njohur kërkesat e tyre ne arrijmë të ndërtojmë punën tonë. Jemi munduar të shpejtojmë proceset e punës, të optimizojmë dokumentacionin që duhet të sjellë aplikanti për kredi, të hartojmë produkte të reja apo të përmirësojmë produktet ekzistuese dhe ky ka qenë dhe do të jetë një proces i vazhdueshëm.

Ne besojmë fort se ta ndërtojmë biznesin mbi atë që kërkon tregu ynë është mënyra më e mirë për t'u zhvilluar më tej. Dhe, kur i hedhim sytë nga zhvillimet në të ardhmen, besojmë se kjo është një pikë e mirë për të filluar – pra, të fillojmë me kërkesën e klientit dhe të vazhdojmë punën për plotësimin e kësaj kërkese.

Strategjia jonë

Vizioni ynë është që të jemi institucioni mikrofinanciar që ofron produktet dhe shërbimin më të mirë për klientët në Shqipëri. Sigurisht, këtë do ta arrijmë duke mbështetur klientët ekzistues dhe ata potencialë me produkte dhe shërbime inovative për të qenë zgjedhja e tyre e preferuar në treg, por edhe për të siguruar rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm afatgjatë.

Mesazhi i Drejtorit Ekzekutiv

Viti 2019 për Fondin BESA shënon një vit sa të suksesshëm, aq edhe të vështirë dhe me sfida, të cilat na u desh t'i përballonim gjatë ecurisë së aktivitetit. Por, në mbyllje të këtij viti jam i kënaqur të ndaj me ju suksesin tonë në arritjen e objektivave, stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e Fondit BESA, kontributin në mbështetjen e biznesit, përmirësimin e nivelit ekonomik të klientëve, në veçanti, impaktin që ka pasur aktiviteti ynë në zhvillimin ekonomik në tërësi.

Suksesi ynë i atribuohet ekipit menaxhues, i mbështetur nga gjithë punonjësit e Fondit BESA dhe nga Këshilli Mbikqyrës, dhe tashmë është në një pozitë shumë më të fortë për të përballuar sfidat e ardhshme. Unë do të doja të filloja duke falenderuar të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë sukses për punën e tyre të vështirë, përkushtimin, profesionalizmin e lartë duke besuar në një të ardhme më të sigurtë. Ambiciet dhe objektivat që synojmë do të na lejojnë të ndërtojmë një institucion më të fortë, më të mirë dhe më të vlefshëm për klientët, punonjësit dhe aksionarët tanë. Ne do të vazhdojmë t'i qëndrojmë besnik parimit tonë kryesor që të mbështesim klientët tanë në zhvillimin e aktiviteteve që kanë nevojë për financim për t'i dhënë jetë ideve dhe aspiratave të tyre. Fondi BESA është gjithnjë pranë progresit, e nxit atë dhe çdo vit bën më të mirën për të qenë inovativ.

Fondi BESA është një nga institucionet mikrofinanciare më të rëndësishëm në vend. Historia e tij 26 vjeçare ka treguar se institucioni ynë është një histori suksesi dhe ka potencial të rëndësishëm për zhvillim të mëtejshëm, në përmbushje të misionit të tij.

Gjatë vitit 2019, Fondi BESA bëri një progres të dukshëm në realizimin e objektivave të tij strategjikë

në lidhje me rritjen e aktivitetit; rritjen e kapitalit; mbajtjen nën kontroll të riskut dhe forcimin e pozicionimit në treg si një partner i besueshëm dhe profesional për klientët dhe gjenerimin e fitimeve për aksionarët në një periudhë afatgjatë. Kjo dëshmon edhe një herë se kemi ndërtuar themele shumë solide si bazë për rritje të sigurtë edhe në të ardhmen.

2019 ishte një vit shumë i rëndësishëm për Fondin BESA, i cili operoi në një sfond ekonomik që u ndikua negativisht nga tërmeti i muajit nëntor që shkaktoi dëme dhe humbje të konsiderueshme ekonomike, çka çoi në rritje ekonomike në nivelin 2.2%, në rënie kundrejt nivelit 4.1% të shënuar në vitin paraardhës dhe humbje ekonomike të vlerësuara në 7.5% të PBB-së.

Në fund të vitit 2019, Fondi BESA rezulton me 82 zyra, duke siguruar mbulim të gjerë dhe të qëndrueshëm, ndërsa numri i punonjësve është rritur duke arritur në 576, krahasuar me 549 në vitin 2018.

Rreth 32,000 klientë aktivë, mbi 18,800 kredi të dhëna gjatë vitit 2019 dhe rritja e konsiderueshme e portofolit të kredisë me 16%, duke arritur në 13.2 miliardë lekë, janë tregues të qartë të përpjekjeve për t'i shërbyer një numri gjithnjë e më të madh klientësh, duke plotësuar nevojat e segmentit tonë të tregut për financim.

Me rreth 227 mijë kredi të dhëna gjithsej në shumën 670 milion Euro, Fondi BESA radhitet ndër institucionet që ka kontribuar në zhvillimin e biznesit mikro, të vogël dhe të mesëm, krijimin e vendeve të punës si dhe përmirësimin e nivelit ekonomik, si rrjedhojë edhe atij arsimor dhe shëndetësor të mijëra familjeve si në zonat urbane ashtu edhe rurale në vend.

Totali i aseteve të Fondit BESA në fund të vitit 2019, rezulton në 18.3 miliardë lekë, duke u rritur me 4.8 miliardë lekë ose 35.5% në krahasim me vitin 2018.

Totali i kapitalit rezulton 3,3 miliardë lekë, me një rritje prej 258milion lekë ose 8.6% krahasuar me vitin 2018.

Portofoli i kredive u rrit në 13.2 miliardë lekë, një rritje prej 15.6% ose rritje e vëllimit prej 1.8 miliardë lekë në krahasim me vitin 2018.

Për sa i përket treguesve të profitabilitetit, në fund të vitit 2019, Fondi BESA krijoi një Kthim në Asete prej 2.6%, ndërsa Kthimi në Kapital ishte 13.25%.

Raporti i Mjaftueshmërisë së kapitalit të Fondit BESA në fund të vitit ishte 17.79%.

Gjatë vitit 2019, Fondi BESA vazhdon të jetë pronar 100% i aksioneve të Institucionit Mikrofinanciar "Social and Agro Fund".

Ecuria e mirë financiare do t'i mundësojë Fondit Besa të rrisë aktivitetin duke rritur numrin e klientëve, zgjeruar e zonës së ndërhyrjes, rritur gamën e produkteve, efikasitetin e proceseve, optimizimin e përdorimit të fondeve, duke e pozicionuar kështu më mirë për përballimin e sfidave dhe uljen e nivelit të riskut.

Në vitin 2019 një zhvillim i veçantë ishte blerja dhe kalimi i zyrës qendrore në objektin e ri modern,

me zyra të një cilësie të lartë që akomodon mbi 150 punonjës duke na mundësuar që të operojmë në përputhje me vlerat dhe objektivat tona si punëdhënës i preferuar në Shqipëri dhe lider në tregun e mikrofinancës.

Fondi BESA ka ndërtuar një strategji, e cila bazohet në zhvillimin e aktivitetit duke u bazuar në pikat e forta të modelit tonë të biznesit. Ne synojmë të arrijmë objektivat tona duke qenë Eficentë, duke minimizuar Riskun, duke qenë të Mirëkapitalizuar dhe Transparentë. Strategjia e Fondit BESA është të bëhet një institucion më i fortë dhe më i sigurtë që është i pozicionuar mirë për të mbështetur tregun e synuar duke ofruar produkte dhe shërbime cilësore. Ne synojmë të përqendrojmë burimet tona në ato segmente të tregut dhe sektorë ku ekziston kërkesa. Tregjet ndryshojnë me kalimin e kohës, po ashtu sjellja dhe preferencat e klientëve ndryshojnë. Ndaj Fondi BESA, do të jetë në zhvillim të vazhdueshëm për t'ju përshtatur kërkesës së tregut. Zhvillimi i produkteve të reja dhe përmirësimi i produkteve ekzistuese është thelbësor për të mbështetur përmbushjen e objektivave tona.

Strategjia jonë për përkrahjen e sektorit të biznesit mikro, të vogël dhe të mesëm do të synojë një rritje prej 6.34% të klientelës aktive, dhe 7.64% të portofolit.

Një nga prioritetet tona kryesore për vitin e ardhshëm do të vazhdojë të jetë rritja e kënaqësisë së klientëve, pasi qëllimi ynë është të ofrojmë produkte dhe shërbime të përshtatura me nevojat e tyre, transparente, të përgjegjshme, me kosto efektive, që i tejkalojnë pritshmëritë e klientëve tanë.

Kur planifikojmë të ardhmen, ne udhëhiqemi nga parimi që të jemi një institucion, i cili bashkon vlerat më të mira të një fuqie punëtore të angazhuar dhe të përkushtuar dhe që inkurajon nivel të lartë të performancës. Ne gjithashtu do të vazhdojmë të rrisim kapacitetin e stafit nëpërmjet një programi trajnimi të avancuar për punonjësit ekzistues dhe ata që do të punësohen në të ardhmen.

Vetëm gjatë vitit 2019 janë zhvilluar 80 seanca trajnimi në 94 ditë dhe janë trajnuar 1,104 punonjës, çka nënkupton se një punonjës ka marrë më shumë se një trajnim.

Ne besojmë se viti 2020, do të vazhdojë të jetë një vit i suksesshëm gjatë të cilit Fondi Besa do të ndërtojë punën mbi progresin e arritur këtë vit, i vetëdijshëm për vështirësitë dhe efektet e pashmangshëm të pasojave të tërmetit në ekonominë e vendit dhe në punën tonë.

Prioritetet tona janë të qarta dhe të mirëpërcaktuara. Forca jonë qëndron në asetin më të çmuar që është stafi ynë, por edhe në partnerët tanë të cilët na kanë mbështetur financiarisht në fuksion të përballimit të sfidave.

Miqësisht

Prof. Asoc. Dr. Bajram MUÇAJ

Drejtor Ekzekutiv

Mjedisi makroekonomik dhe zhvillimet kryesore në Sistemin Financiar Shqiptar

- Gjatë vitit 2019 ekonomia shqiptare rezultoi me një rritje në nivelin 2.2%, në rënie kundrejt nivelit 4.1% të shënuar në vitin 2018.
- Goditjet që pësuam nga tërmeti i nëntorit ngadalësuan ritmin e rritjes ekonomike, por nuk e shmangën ekonominë nga trendi pozitiv i zhvillimit. Kjo ecuri u pasqyrua në reduktimin e normës së papunësisë, e cila zbriti në minimumin historik prej 11.2%, në rritjen e punësimit dhe të pagave, si dhe në reduktimin e borxhit të huaj dhe atij publik.
- Inflacioni mesatar i vitit 2019 rezultoi në nivelin 1.4%, duke ardhur në rënie nga viti i shkuar që shënoi 2.0%.
- Banka e Shqipërisë mbajti të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 1.0%, orientoi tregun drejt ruajtjes së kahut lehtësues të politikës monetare në horizontin afatmesëm, si dhe furnizoi bankat me të gjithë likuiditetin e nevojshëm.
- Numri i bankave u reduktua në 12, nga 14 banka që operonin në fund të vitit 2018, si pasojë e përthithjes së një banke si dhe vetëlikuidimit të një banke tjetër.
- Treguesi më i rëndësishëm i mbikëqyrjes, ai i mjaftueshmërisë së kapitalit, rezulton në nivelin 18.3%, me një rënie prej 0.38 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2018.
- Treguesi i kredive me probleme pësoi një rënie prej 2.72 pikë përqindjeje në terma vjetorë, duke arritur në 8.4% në fund të vitit 2019. Kredia me probleme arriti nivelin 48.18 miliardë lekë, duke u ulur me 16.18 miliardë lekë ose 25.1% krahasuar me një vit më parë.
- Ndërkohë, portofoli i kredive rezulton në rënie me 4.94 miliardë lekë ose 0.85%.
- Treguesit e përfitueshmërisë, përkatësisht kthimi nga aktivet mesatare (RoAA) dhe kthimi nga kapitali aksioner mesatar (RoAE) shfaqen në rritje krahasuar me vitin 2018. Vlerat, në fund të vitit 2019, shfaqen në 1.39% për RoAA dhe 13.45% për RoAE, ndërsa në fund të vitit 2018 këta tregues ishin përkatësisht 1.32% dhe 12.96%.
- Në dhjetor 2019, raporti i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra për sistemin bankar rezultoi 49.40%9, me një rritje prej 3.19 pikë përqindjeje krahasuar me 2018;
- Vlera totale e depozitave të sistemit arrin 1.193 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 1.1%, krahasuar me 2018. Pesha e monedhës vendase në totalin e depozitave është rritur në 48.51%, nga 46.87% në dhjetor 2018;

- Rezultati financiar i vitit 2019 ishte pozitiv, me një vlerë prej rreth 19.89 miliardë lekësh, ose 1.5 miliardë lekë më i lartë se ai i vitit 2018.
- Kapitali aksioner i sistemit bankar arriti në vlerën 154.23 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 6.77 miliardë lekësh, ose 4.6% kundrejt një viti më parë.
- Struktura e kapitalit vijon të dominohet nga kapitali i huaj, i cili përfaqëson rreth 77.16% të kapitalit të paguar të sistemit bankar, me një rënie prej rreth 6.29 pikë përqindjeje kundrejt fundit të vitit 2018.
- Gjatë vitit 2019, aktivet e sistemit bankar shënuan rritje prej rreth 22.1 miliardë lekësh ose 1.52%, përkundrejt rënies me 8.12 miliardë lekë ose 0.56% të një viti më parë.
- Pesha që zë sistemi bankar në ekonomi, e shprehur nëpërmjet raportit të totalit të aktiveve ndaj PBB, vijon të qëndrojë në nivele të larta, pavarësisht se këtë vit, treguesi është ulur me 1.43 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 87.92%.
- Ndërkohë, raporti i kredive ndaj Produktit të Brendshëm Bruto ka pësuar rënie, si pasojë e rritjes së PBB-së kundrejt rënies së portofolit të kredive.
- Deficiti buxhetor për vitin 2019 rezultoi në nivelin 31.5 miliardë lekë, ose rreth 1.9% të PBB-së.
- Shkalla e papunësisë ndoqi tendencën rënëse të shfaqur që prej vitit 2016, duke qëndruar në tremujorin e tretë 2019 në nivelin historik më të ulët, rreth 11.4%.6

Subjektet Financiare Jobanka

Në dhjetor 2019, numërohen 32 subjekte financiare.

- Totali i aktiveve për SFJB, në dhjetor 2019, arrin në nivelin 58.1 miliardë lekë, duke u rritur me rreth 11.8 miliardë lekë ose 25.4%. Kjo rritje është gjeneruar kryesisht nga subjektet: Fondi Besa (41%), Iutecredit Albania (16%), Kredo Financë (11%), NOA (8%), Raiffeisen Leasing (8%).
- Aktivet e SFJB zënë rreth 3.9% të totalit të aktiveve të sistemit bankar, duke u rritur me 0.8 pikë përqindje krahasuar me vitin 2018.
- Zëri dominues në strukturën e aktiveve të SFJB është portofoli i kredisë me rreth 50.4%. Pjesa tjetër e aktiveve është e orientuar drejt mjeteve likuide (24.5%) dhe letrave me vlerë me të ardhura të ndryshueshme (8.7%).
- Burimet kryesore të financimit vijojnë të jenë huamarrjet (52% e pasivit) dhe zërat e kapitalit (39% e pasivit), ndërsa huamarrja nëpërmjet emetimit të obligacioneve përbën 0.7% të pasiveve.

- Gjatë vitit 2019, pjesa më e madhe e SFJB janë paraqitur të mirëkapitalizuara.
- Në fund të vitit 2019, portofoli i kredive bruto të SFJB arrin në 35.5 miliardë lekë, duke njohur një rritje me rreth 6.8 miliardë lekë (ose 23.7%) krahasuar me vitin paraardhës. Ndikimin më të madh në këtë rritje e ka dhënë veprimtaria e mikrokredisë me 2.95 miliardë lekë, ndërsa kredidhënia dhe qiraja financiare janë rritur përkatësisht me 1.97 dhe 1.93 miliardë lekë. Veprimtaria e faktoringut ka rënë me 61.3 milionë lekë.
- Pjesa më e madhe e portofolit të ekspozimeve të SFJB mbahet nga subjektet e kredidhënies dhe mikrokredisë (73.5%), ndjekur nga portofoli i subjekteve të qirasë financiare (25%) dhe portofoli i subjekteve faktoring (1.5%).
- Portofoli i kredidhënies për SFJB përbën 5.7% të portofolit të sistemit bankar.
- Në fund të vitit 2019, aktivitetet e subjekteve të kredidhënies mbeten të orientuara drejt biznesit, përkatësisht me rreth 71% dhe 82%. Krahasuar me vitin 2018, vihet re një rritje e kreditimit të individëve kundrejt biznesit (29% vs 20%), e cila ka ardhur kryesisht si pasojë e veprimtarisë së mikrokredisë.
- Sektorët më të financuar janë “Aktivitete të tjera shërbimi” (40%), “Tregtia, riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiakë” (23%) dhe “Bujqësia, pyjet, peshkimi”(14%).
- Portofoli i SFJB-ve mbetet i orientuar drejt financimeve në monedhën vendase (64.4%) dhe me afat të mesëm maturimi (61.7%).
- Në fund të vitit 2018, treguesi i kredive me probleme për subjektet financiare është rritur me 0.5 pikë përqindje. Ky rezultat është ndikuar nga rritja e kredive me probleme me rreth 56.8% (ose 1.5 miliardë lekë), ndërkohë që rritja e portofolit të financimeve ka qenë rreth 23.7%.
- Gjatë vitit 2019, SFJB kanë njohur një rezultat pozitiv prej 3.46 miliardë lekësh. Ky rezultat është rritur me rreth 1.76 miliardë lekë (ose 103.5%) krahasuar me vitin paraardhës. Rezultati financiar është ndikuar kryesisht nga subjektet: Fondi Besa, Tranzit, Iute Credit Albania, Unioni Financiar Tiranë dhe NOA. Rezultati i SFJB përbën rreth 15% të rezultatit të sistemit bankar.

Fondi BESA
në shifra 2019

Kredi të disbursuara në vit
18,808

Asete Totale
18.28 miliardë Lekë
150.15 milion Euro

Portofoli i Kredisë
13.23 miliardë Lekë
108.63 milion Euro

Kapital Total
3.25 miliardë Lekë
26.70 milion Euro

Volumi i disbursuar në vit
9.81 miliardë Lekë
80.58 milion Euro

Shuma Kumulative
81.65 miliardë Lekë
670.51 milion Euro

Kthimi mbi Asetet
2.60%

Klientë Aktivë
31.733

Kthimi mbi Kapital
13.25%

Prioritetet dhe objektivat kryesore operacionale në kredidhënie për periudhën afat-mesme 2020-2021-2022

Objektivi kryesor i aktivitetit të Fondit BESA për tre vitet e ardhshme mbetet dhënia e kredive kryesisht për bizneset mikro dhe të vogla.

Kjo kredidhënie do të rritet jo vetëm nga pikëpamja sasiore (tepricë kredie; kredi aktive; disbursime), por edhe nëpërmjet zgjerimit të gamës së kredive për t'iu përshtatur sa më mirë kërkesave dhe "evoluimit" të tregut dhe të klientëve tanë.

Objektivat kryesore afat-mesme 2020-2021-2022

Objektivi Strategjik:

Të kontribuojë në rritjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisë së vendit në zonat urbane, gjysmë-urbane dhe me një aktivitet të shtuar në zonat rurale duke nxitur sektorin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe të fermave bujqësore nëpërmjet ofrimit të kredive të përshtatura sipas nevojave të tregut të synuar.

Për të arritur këtë objektiv strategjik, Fondi BESA do të synojë realizimin e sa më poshtë:

- Dhënia rreth **35.42 miliardë lekë** gjatë tre viteve të ardhshme.
- Shtrirja e zyrave dhe shërbimeve në Zyra të Reja Rajonale dhe zgjerimi në Degë të reja.
- Te rrisë produktivitetin dhe efektivitetin e stafit në të gjitha nivelet
- Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për implementimin e shërbimeve dhe produkteve të reja që do të ndikojë në përmirësimin e efiçencës financiare të aktivitetit të Fondi BESA.
- Ruajtja dhe përmirësimi i vetë-qëndrueshmërisë financiare në tre vitet e ardhshme.
- Ruajtja e treguesve dhe indikatorëve në përputhje me rregulloret e mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë.

Zhvillimi institucional



Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve ka funksion strategjik në Fondin Besa, sepse menaxhon asetin më të çmuar – stafin.

Që nga krijimi e në vazhdimësi, Fondi BESA në mënyrë të qëndrueshme ka një fokus të veçantë tek punonjësit, të cilët konsiderohen si forca shtytëse e suksesit të aktivitetit tonë, që me profesionalizmin e tyre dhe me përkushtim ndikojnë drejtpërsëdrejti në suksesin dhe rezultatet e arritura.

Duke vlerësuar maksimalisht punonjësit dhe kontributin e tyre, synim kryesor i Fondit BESA në këtë aspekt është të ketë profesionistët më të mirë në treg, të cilëve iu ofrohen të gjithë mundësitë dhe mjetet e nevojshme për realizimin e objektivave.

Por, tregu është në zhvillim të pandërprerë dhe strategjitë e reja të institucionit kërkojnë jo vetëm zhvillimin me aftësi të reja të punonjësve ekzistues, por edhe prezantimin e ekspertizave të reja. Ne e konsiderojmë si një mision të veçantë zhvillimin e burimeve njerëzore dhe gjatë vitit 2019 Fondi BESA, bazuar në planin e tij për zhvillim, ka organizuar trajnime të ndryshme si brenda ashtu edhe jashtë vendit, shkëmbime eksperiencash, kemi marrë pjesë në konferenca të organizuara në fushën e mikrofinancës etj.

Gjatë vitit 2019 i kemi kushtuar rëndësi trajnimit të të gjithë niveleve të stafit, ku numri i përgjithshëm i pjesëmarrjeve përfitues ishte 1,104 punonjës. Janë zhvilluar gjithsej 80 trajnime në 94 ditë.



Ne e konsiderojmë shumë të rëndësishme që punonjësit tanë të kuptojnë se cili është roli dhe cilat janë detyrat e tyre, të kuptojnë çfarë pritet prej tyre dhe cila është qasja ndaj klientëve me qëllim ruajtjen e tyre dhe krijimin e marrëdhënievë të besimit dhe të bashkëpunimit sa më të mirë.

Gjatë gjithë kohës, Departamenti i Burimeve Njerëzore ndjek dhe monitoron me kujdes ecurinë e punonjësve për të parë zhvillimin e tyre, për të kuptuar aftësitë e tyre profesionale dhe njerëzore, ambiciet dhe rezultatet e tyre. Kjo na nevojitet për të kuptuar edhe ne perspektivën dhe ambiciet e punonjësve, kryesisht aftësitë e tyre profesionale, për t'i konsideruar në rritjen e tyre në karrierë, dhe për t'u caktuar atyre objektiva ambicioze dhe të studiuara mirë.

Ne vazhdojmë të vemë theksin në rritjen e numrit të femrave në të gjitha nivelet e institucionit dhe jemi shumë krenarë të themi se kemi:

- Femra në nivelin e menaxhimit te lartë: **50%**
- Femra në nivel drejtore dege: **37%**
- Femra në Këshillin Mbikqyrës: **29%**
- Femra në Fondin BESA: **46%**
- Femra oficere kredie: **39.4%**

Gjatë aktivitetit të tij, Departamenti i BNJ ka punuar për ta mbajtur stafin të informuar mbi strategjinë e Fondit Besa, progresin e çdo dege dhe të institucionit në përgjithësi dhe nivelin e performancës, nëpërmjet takimeve të shpeshta, informacioneve mujore mbi aktivitetin dhe analizave periodike të aktivitetit.

Ne punojmë shumë që punonjësit tanë të identifikojnë veten me institucionin, të respektojmë diversitetin e stafit, të ruajmë në institucion njerëzit me ekspertizë dhe që e njohin mirë filozofinë e institucionit, sigurisht duke i hapur rrugë talenteve të reja për progres. Një pikë e fortë e Fondit BESA është edhe fakti se ekziston një ndjenjë e thellë e besnikërisë së punonjësve ndaj institucionit.

Bilanci

Shifrat në lekë	**31 dhjetor 2019**	**31 dhjetor 2018**
AKTIVET		
Mjete monetare dhe ekuivalente	2,057,574,547	227,259,893
Depozita me afat me bankat	2,018,363,291	932,070,039
Hua dhënë klientëve, neto	12,277,228,994	10,754,136,151
Aktive afatgjata materiale	1,194,423,903	1,069,142,040
Inventari i aktiveve te riposeduara	262,396,082	269,173,491
Aktivet te mbajtura për shitje	-	6,574,849
E drejta e përdorimit të aktiveve	249,052,430	-
Investime ne filial	66,648,400	66,648,400
Investime në pjesëmarrje	31,950,000	89,900,000
Parapagim i tatimit mbi fitimin	54,825,072	19,409,960
Aktive te tjera	71,757,167	62,964,269
Totali i Aktiveve	**18,284,219,886**	**13,497,279,092**
DETYRIMET		
Hua	12,651,511,122	8,416,090,316
Borxhi i varur	1,939,777,082	1,901,685,559
Grantet	24,353,996	24,683,996
Tatime të tjera të pagueshme	17,719,003	12,689,507
Detyrim ndaj qirasë	250,935,465	-
Detyrime te tjera	147,916,902	147,852,678
Totali i Detyrimeve	**15,032,213,570**	**10,503,002,056**
KAPITALI		
Kapitali Aksionar	2,713,401,000	2,536,018,000
Rezerva ligjore	124,723,035	107,168,379
Fitime të mbartura	413,882,281	351,090,656
Totali i Kapitalit	**3,252,006,316**	**2,994,277,035**
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit	**18,284,219,886**	**13,497,279,092**

Kursi i Këmbimit : 31.12.2019 US$/Lekë: 108.64 EUR/Lekë 121.77

Kursi i Këmbimit : 31.12.2018 US$/Lekë: 107.82 EUR/Lekë 123.42

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Shifrat në lekë	**31 dhjetor 2019**	**31 dhjetor 2018**
Interesa		
Të ardhura nga Interesat	3,016,347,068	2,466,598,097
Shpenzime për Interesat	(554,415,673)	(412,273,300)
Marzhi neto i interesave	**2,461,931,395**	**2,054,324,797**
Të ardhura të tjera		
Të ardhurat nga donacionet	15,049,856	2,395,140
Të ardhura të tjera, neto	16,766,466	16,369,094
Totali i të ardhurave të tjera	**31,816,322**	**18,764,234**
Shpenzime Operative		
Humbje nga zhvlerësimi i kredive për klientët	(657,542,254)	(366,463,689)
Shpenzime personeli	(800,227,221)	(720,230,293)
Shpenzime të tjera administrative	(298,141,133)	(388,939,852)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(217,767,252)	(69,230,224)
Humbjet neto nga lëvizjet në kursin e këmbimit	4,716,924	63,537,394
Totali i shpenzimeve operative	**(1,968,960,936)**	**(1,481,326,664)**
Fitimi para tatimit	**524,786,781**	**591,762,367**
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin	(110,904,500)	(138,688,345)
Fitimi neto për vitin	**413,882,281**	**453,074,022**
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	**413,882,281**	**453,074,022**
Fitimi neto për vitin/ Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		
- Të atribueshme ndaj mëmës	271,589,553	298,530,473
- Të atribueshme ndaj interesave të pakicës	142,292,728	154,543,549
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	**413,882,281**	**453,074,022**

Kursi i Këmbimit : 31.12.2019 US$/Lekë: 108.64 EUR/Lekë 121.77

Kursi i Këmbimit : 31.12.2018 US$/Lekë: 107.82 EUR/Lekë 123.42

Pasqyra e flukseve të parasë

Shifrat në lekë	**31 dhjetor 2019**	**31 dhjetor 2018**
Flukset monetare nga aktivitetet operative		
Fitimi përpara tatimit mbi të ardhurat	524,786,782	591,762,368
Korrigjim për		
Zhvlerësim dhe amortizim	217,767,252	69,230,224
Fshirja e kolateraleve te riposeduara	-	6,441,603
Humbje/(Fitim) nga nxjerrja jashtë përdorimi e aktiveve	(4,153,902)	(4,883,435)
Zhvlerësime dhe korrigjime të tjera të huave për klientët	432,280,161	380,732,232
Hua të fshira	270,254,370	39,091,511
Amortizimi granteve	(15,049,856)	(2,395,140)
Diferenca të kursit të këmbimit	(4,716,924)	(63,537,394)
Tarifa e përmbarimit për zhvlerësimin	-	23,905,788
Të ardhura nga interesat	(3,016,347,068)	(2,466,598,097)
Shpenzime për interesa	554,415,673	412,273,300
Ndryshime në:		
Hua për klientë	(2,279,836,847)	(3,242,316,420)
Aktivet e mbajtura për shitje	6,574,849	3,291,496
Aktive të tjera	6,732,606	(5,873,575)
Detyrime të tjera	3,787,482	(6,769,204)
Interes i arkëtuar	3,047,504,526	2,393,093,085
Interes i paguar	(571,168,689)	(396,860,270)
Tatimi mbi fitimin i paguar	(148,007,891)	(129,340,224)
Flukse monetare neto nga aktivitetet operative	**(975,177,476)**	**(2,398,752,151)**

Kursi i Këmbimit : 31.12.2019 US$/Lekë: 108.64 EUR/Lekë 121.77

Kursi i Këmbimit : 31.12.2018 US$/Lekë: 107.82 EUR/Lekë 123.42

Shifrat në lekë	**31 dhjetor 2019**	**31 dhjetor 2018**
Flukse monetare nga aktivitete investuese		
Blerje e pajisjeve	(245,184,581)	(929,244,947)
Ndryshime në depozitat me afat	(1,101,181,519)	(283,875,285)
Investimet në kapital	57,950,000	(17,576,400)
Të ardhurat nga shitja e aktiveve fikse	35,885,677	24,222,443
Flukse monetare përdorur në aktivitetet investuese	**(1,252,530,423)**	**(1,206,474,189)**
Flukset monetare nga aktivitete financuese		
Të ardhura nga huatë dhe detyrimet e varura, neto	4,336,819,007	3,115,487,803
Të ardhurat nga grantet	15,049,852	15,128,140
Dividendi i shpërndarë	(156,153,000)	-
Pagesa e detyrimeve te qirasë	(119,255,149)	-
Flukset monetare nga aktivitete financuese	**4,076,460,710**	**3,130,615,943**
Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalente	1,848,752,811	(474,610,397)
Ndikimi i kursit të këmbimit	(18,438,157)	25,736,805
Mjete monetare dhe ekuivalente në fillim të vitit	227,259,893	676,133,485
Mjete monetare dhe ekuivalente në fund të vitit	**2,057,574,547**	**227,259,893**

Kursi i Këmbimit : 31. 12. 2019 US$/Lekë: 108.64
EUR/Lekë 121.77

Kursi i Këmbimit : 31. 12. 2018 US$/Lekë: 107.82
EUR/Lekë 123.42

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit

(Shuma në LEK)	**Kapitali aksionar**	**Rezerva ligjore**	**Fitimet e Akumuluara**	**Totali**
Gjendja më 1 Janar 2018	2,151,191,000	86,913,660	405,081,719	2,643,186,379
Impakti I adoptimit te SNFR 9	0	0	(101,983,366)	(101,983,366)
Gjendja e riparaqitur nen SNFR 9	2,151,191,000	86,913,660	303,098,353	2,541,203,013
Totali I të ardhurave përmbledhëse				
Fitimi neto I vitit	0	0	453,074,022	453,074,022
Totali të ardhurave përmbledhëse	0	0	453,074,022	453,074,022
Lëvizje të tjera në kapital				
Përvetësim I fitimit të mbartur	384,827,000	20,254,719	(405,081,719)	0
	384,827,000	20,254,719	(405,081,719)	0
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	2,536,018,000	107,168,379	351,090,656	2,994,277,035
Totali të ardhurave përmbledhëse				
Fitimi I vitit	0	0	413,882,281	413,882,281
Totali të ardhurave përmbledhëse	0	0	413,882,281	413,882,281
Lëvizje të tjera në kapital				
Përvetësim I fitimit të mbartur	177,383,000	17,554,656	(194,937,656)	0
Dividendi I shpërndarë	0	0	(156,153,000)	(156,153,000)
	177,383,000	17,554,656	(351,090,656)	(156,153,000)
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	2,713,401,000	124,723,035	413,882,281	3,252,006,316

Menaxhimi i rrezikut në Fondin Besa

Menaxhimi i rrezikut në Fondin Besa konsiston në identifikimin dhe matjen e rrezikut me qëllim që drejtuesit e Fondit të marrin vendime për shmangien dhe zvogëlimin e tij si dhe në vlerësimin e mundshëm të humbjeve, në përgjigje të plotësimit të kërkesave të kuadrit rregullator të veprimtarisë të subjekteve financiare jobankë.

Fondi Besa, si një aktivitet normal biznesi, përballet me lloje të ndryshme rreziqesh, të cilat ndiqen me kujdes nga institucioni ku veçohen rreziqet kryesore të biznesit:

Rreziku i kredisë është rreziku që klienti te mos shlyejë detyrimet e Kredisë sipas kontratës së lidhur për këtë qëllim. Rreziku i kredisë është rreziku që ndryshimi në cilësinë e kredisë do të ndikojë në vlerën e pozicionit të Fondit Besa. Ai përfshin edhe humbjen e të ardhurave të parashikuara të interesit, ashtu si humbjen që rezulton nga mospagimi i kredisë.

Rreziku i likuiditetit është rreziku në rastet kur institucioni nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet në kohën e duhur, ose në rastet kur nuk arrin të marrë fonde me çmim të pranueshëm për të financuar angazhimet aktuale apo ato të propozuara, ose për arsye se asetet nuk mund të likuidohen. Ky është një tregues që ndiqet me kujdes nga institucioni dhe në vijimësi ka qenë brenda normave prudente të mbikëqyrësit dhe politikave të brendshme të institucionit.

Rreziku i normave të interesit nënkupton ekspozim ndaj variablave të monitorueshme të tregut për normat e interesit. Në përgjithësi, Fondi Besa nuk ka ekspozim të lartë, pasi ka norma fikse si në dhënien e kredive ashtu edhe në marrjen e fondeve.

Rreziku nga kursi i këmbimit është mundësia që vlera e instrumenteve financiare të luhatet për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit. Ekspozimet në valutë të huaj të kompanisë sjellin fitime dhe humbje në valutë të huaj që njihen në fitim ose humbje. Këto ekspozime përfshijnë aktivet dhe detyrimet e kompanisë që nuk janë të paraqitura në monedhën vendase. Pozicioni i hapur valutor i kompanisë ka qenë nën kontroll në vijimësi dhe gjithmonë brenda limiteve të autoritetit mbikëqyrës ashtu si dhe politikave të brendshme të institucionit.

Fitimi

Rezultatet financiare për vitin 2019, tregojnë angazhimin e menaxhimit dhe punonjësve të Fondit BESA për përmbushjen e një viti tjetër të suksesshëm. Në fund të vitit 2019, me gjithë vështirësitë dhe sfidat që përballoi, Fondi Besa ka përmbushur objektivat e tij në të gjithë treguesit kryesorë, krahasuar me planin e Biznesit, ndërsa vazhdon një performancë shumë të mirë financiare, rritje dhe vetëfinancim, cilësi të portofolit, menaxhimin e likuiditetit dhe ruajtjen e një strukture optimale të kapitalit që lejon përmbushjen e kthimit

të investime, shikuar nga perspektiva e aksionarit. Fitimi neto për vitin 2019 është 413,882,281 Lekë.

Kapitali i aksionarëve

Fondi BESA vazhdon të jetë i kapitalizuar mirë, duke ruajtur raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit prej 17.79%, që është më e lartë se minimumi i kërkuar prej jo më pak se 10%. Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve vendosi që të ketë shpërndarje të dividentëve për aksionarët, në shumën prej 156,153,000 lekë.

Përgjegjshmëria sociale

Fondi BESA vazhdon të jetë i angazhuar të mbajë standarde të larta etike në të gjithë aktivitetin e tij, nuk pranon asnjë formë diskriminimi dhe përgjegjësia sociale e kompanisë përfshin komunikim transparent dhe të qartë, aktivitete të përgjegjshme, sjellje etike dhe promovim të barazisë, diversitetit dhe një mjedisi të shëndoshë pune. Aktiviteti ynë është bazuar gjithmonë në premtimin për të qenë një institucion i përgjegjshëm, gjë e cila pasqyrohet në vlerat tona dhe në mënyrën se si zhvillojmë produktet dhe në qasjen ndaj klientelës. Fondi BESA e konsideron përgjegjësinë sociale një mjet thelbësore që plotëson misionin tonë financiar dhe ekonomik.

Fondi BESA e lidh ngushtë suksesin e tij afatgjatë me rolin e vet në shoqëri, në lidhje me ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e komunitetit. Ne vazhdojmë të lidhim strategjinë dhe politikat tona me objektivat mjedisore dhe sociale. Në këtë kuadër, Fondi BESA është i angazhuar në projekte të ndryshme me karakter social, kulturor dhe edukativ.

Disa nga projektet e mbështetura gjatë vitit 2019 nga Fondi BESA janë:

Trajnim me të rinjtë “SI TË NISNI BIZNESIN TUAJ”

Në Mars 2019, Fondi Besa realizoi trajnimin me temë “Si të nisni biznesin tuaj” me 14 të rinj nga zona e Malësisë së Madhe, në kuadër të projektit “Zana e Maleve” në bashkëpunim me VIS Albania dhe Fondacionin PFD. Qëllimi i trajnimit ishte të udhëzonte të rinjtë për të eksploruar mundësitë e vetëpunësimit dhe si t’i drejtojë ata për të ndërmarrë hapat që duhet të ndjekin për fillimin e një biznesi. Ne i ndihmojmë të rinjtë në rrugën e tyre që të bëhen të pavarur financiarisht, çka i ndihmon ata edhe të integrohen më lehtësisht në shoqëri, mision ky që është i shprehur edhe në një produkt të veçantë që ne ofrojmë “Kredi për Rininë”.

Fondi BESA zhvilloi në Universitetin Evropian të Tiranës një leksion të hapur në lëndën “Financat e Ndërmarrjes”.

Ky leksion u referua nga përfaqësuesit e Fondit BESA me pjesëmarrës studentë dhe pedagogë të Universitetit. Leksione të tillë konsiderohen si një mundësi për të shpjeguar realitetin e mikrofinancës në Shqipëri, rregullat dhe procedurat për zhvillimin e aktivitetit dhe menaxhimin e riskut dhe si një urë lidhëse midis universiteteve dhe institucionit tonë.

Një nga komponentët me anë të të cilit Fondi BESA synon realizimin e misionit të tij social është edhe integrimi i të rinjve në shoqëri, nëpërmjet edukimit financiar, mundësisë për kryerjen e praktikave mësimore apo për punësim pas mbarimit të studimeve universitare si dhe financimit të ideve të tyre për të filluar një biznes.

Fondi Besa, një nga sponsorët e Konferencës së 22-të të MFC-së e cila u zhvillua në Stamboll, Turqi më 30 - 31 MAJ 2019 me temë “Demistifikimi i Dixhitalizimit në Mikrofinancë” dhe që solli bashkë më shumë se 500 aktorë kryesorë, praktikues dhe sponsorë të industrisë së mikrofinancës nga Evropa Lindore dhe Perëndimore, Azia Qendrore, Kaukazi dhe madje edhe më gjerë. Konferenca trajtoi anën praktike të dixhitalizimit në sektorin e përfshirjes financiare përmes studimeve të rasteve, analizës së tendencave dhe diskutimit të praktikave më të mira në zhvillim. Një sesion i veçantë në konferencë iu dedikua edhe Instrumenteve Financiare të Programit për ‘Punësim dhe Inovacion Social’ (EaSI), ku u prezantua edhe rasti i Fondit BESA.

Fondi Besa në mbështetje të vlerave të muzikës

Violinisti i mirënjohur, virtuozi Olen Çezari kthehet përsëri në skenën shqiptare për të sjellë për publikun performancën e tij të shkëlqyer artistike dhe tingujt më të bukur të muzikës shqiptare dhe botërore. Fondi BESA sh.a është një nga sponsorët e eventit.

Nëpërmjet mbështetjes së këtij eventi, që komunikon vlerat universale të muzikës, Fondi Besa tregoi edhe një herë vëmendjen që i kushton artit, kulturës dhe muzikës.

Fondi Besa merr pjesë në Panairet e Punës për vitin 2019

organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në rrethe të ndryshme.

Këto panaire synojnë të vendosin marrëdhënie konkrete bashkëpunimi dhe komunikimi, midis ofertës dhe kërkesës në tregun e punës, për të prezantuar mundësitë që ofron tregu i punës.

Duke qenë një nga 50 punëdhënësit më të mëdhenj në Shqipëri, Fondi BESA fokusohet në tërheqjen dhe punësimin e të rinjve, të punonjësve me eksperiencë nga sektori bankar dhe financiar në përgjithësi dhe ky panair konsiderohet si një mundësi konkrete për kontaktimin e individëve që janë në kërkim të një pune.

Fondi BESA mbështet sportin duke sponsorizuar Kupën e Shqipërisë në Bodybuilding dhe Fitness – Maj 2019

Federata shqiptare e Bodybuiding & Fitness organizoi më datë 04 Maj 2019 në sallën e koncerteve të Universitetit të Arteve të Tiranës, Kupën e Shqipërisë në Bodybuilding dhe Fitness për vitin 2019. Në këtë eveniment të rëndësishëm morën pjesë 46 sportistët më të mirë nga qytete te ndryshme të Shqipërisë, me pjesëmarrjen më të madhe se asnjë herë tjetër të sportisteve femra të ndara

në 7 kategori, të cilat me performancën e tyre i dhanë vlera më shumë këtij spektakli sportiv duke u bërë shembull dhe motivuese për vajza të tjera. Në vazhdën e kujdesit që shpreh Fondi Besa për zhvillimin e arteve dhe të sportit në Shqipëri, për ne nuk ishte e vështirë t'i thonim po këtij sponsorizimi, duke konsideruar se bodybuilding është një ndër sportet që kërkon dedikim dhe determinim, vlera këto që në kulturën tonë institucionale zënë një vend të rëndësishëm. Fondi BESA do të vazhdojë të mbështesë aktivitete të rëndësishme të kulturës dhe sportit pasi përgjegjësia sociale është një nga prioritetet tona duke u bërë shembull i ndërgjegjësimit të biznesit në shërbim të mbështetjes së kulturës dhe sporteve në Shqipëri.

Fondi Besa merr pjesë në panairin e "Pranverës" 4 të agrobiznesit dhe artizanatit në Cërrik, Elbasan. Fondi Besa merr pjesë në panair me synimin për të qenë afër biznesit dhe për të shprehur edhe një herë ambicien e tij si mbështetës dhe partner i biznesit të vogël dhe fermerëve në nevojën e tij për financim.

Tetor 2019: Fondi Besa merr pjesë në tryezën e parë të diskutimeve me temë: "Mikrofinanca e së nesërmes, Digjitalizimi i Institucioneve të Mikrofinancës"

Ky takim u organizua nga Shoqata Shqiptare e Mikrofinancës, në bashkëpunim me Microfinance Centre (MFC) dhe me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Takimi i parë u ndal në kuadrin ligjor, rregullator dhe atë të përputhshmërisë, të lidhur me procesin e digjitalizimit të shërbimeve dhe produkteve të mikrofinancës. Institucionet financiare, anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare po intensifikojnë përpjekjet për të qenë jo vetëm në një hap me sektorë të tjerë të ofrimit të shërbimeve financiare në vend, por pse jo, edhe pararojë e tyre. Në takim morën pjesë

përfaqësues nga Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Shoqata e Bankave, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, si edhe përfaqësues të Institucioneve të Mikrofinancës, ekzekutivë të fushës juridike dhe rregullatore, dhe juristë me eksperiencë në fushën e legjislacionit të digjitalizimit.

Tetor 2019: Fondi BESA merr pjesë në Ditën e Mikrofinancës Evropiane: Fuqizimi i Sipërmarrësve të së Nesërmes, që u organizua Bruksel

Dita Evropiane e Mikrofinancës u lançua në 2015 si një mjet për të nënvizuar ndikimin e sektorit të Mikrofinancës në Evropë nga një perspektivë sociale dhe ekonomike.

Objektivat kryesore të Ditës Evropiane të Mikrofinancës janë:

- Të rritet ndërgjegjësimi midis qytetarëve evropianë mbi ekzistencën e mikrofinancës dhe vlerën e saj për të luftuar papunësinë dhe përjashtimin social.
- Të tërheqë vëmendjen e mediave evropiane se si funksionon mikrofinanca në Evropë dhe si mbështet dhe ndihmon të papunët dhe qytetarët evropianë të përjashtuar nga sektori tradicional financiar.
- Të shkëmbehen përvoja brenda sektorit të Mikrofinancës Evropiane.

Tetor 2019: Tetor 2019: Gjatë Ditës Evropiane të Mikrofinancës u organizua edhe Ceremonia e dhënies së Certifikatave të European Code of Good Conduct.

Fondi BESA u vlerësua nga Komisioni Evropian me Certifikatën e Përputhshmërisë **European Code of Good Conduct for Microcredit Provision.**

Nëntor – Dhjetor 2019: Fondi BESA dhe gjithe stafi solidarizohen me me familjet e prekura nga tërmeti.

Pas tërmetit shkatërrues të Nëntorit 2019, Fondi Besa u gjend menjëherë pranë familjeve të prekura nga tërmeti, duke kontribuar me artikuj të nevojave emergjente si ushqime, batanije, dhe veshje. Solidaritet shprehën të gjithë punonjësit e Fondit Besa duke u bërë pjesë e kontributit në mbështetje të klientëve apo edhe punonjësve të cilët patën pasoja nga ky tërmet.

Nëntor 2019: Fondi Besa merr pjesë në tryezën e dytë të diskutimit në kuadër të një serie diskutimesh me temë: "Mikrofinanca e së nesërmes, Digjitalizimi i Institucioneve të Mikrofinancës".

Ky aktivitet u organizua nga Shoqata Shqiptare e Mikrofinancës, në bashkëpunim me Microfinance Centre (MFC) dhe me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Ky takim u ndal në kuadrin operacional, atë të shkëmbimit të të dhënave dhe sigurisë kibernetike, të lidhur ngushtësisht me procesin e transformimit digjital të institucioneve të mikrofinancës. Në këtë kuadër, u diskutua mbi sfidat që hasin Institucionet e Mikrofinancës në krijimin e një procesi tërësisht digjital të ofrimit të produkteve dhe shërbimeve në drejtim të integrimit me platforma publike dhe private, me qëllim automatizimin e proceseve të kredidhënies, ideimin dhe krijimin e algortimeve për vendimmarrjen automatike në kredidhënie, përdorimin e platformave digjitale për mbledhjen e pagesave të kësteve të kredive nëpërmjet tyre (të ashtuquajturat e-wallets), si edhe ekzekutimin praktik të transaksioneve në distancë nëpërmjet nënshkrimit elektronik. Në takim morën pjesë përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, Autoriteti Kombëtar i Certifikimeve dhe Sigurisë Elektronike, ALEAT, shoqëri të ofrimit të shërbimeve të zhvillimit të software-ve për institucionet e mikrofinancës, si edhe përfaqësues të institucioneve të mikrofinancës, ekzekutivë të fushës operacionale dhe te teknologjisë së informacionit.

Dhjetor 2019: Fondi BESA sh.a. dhe Rural Credit Guarantee Foundation-Albania nënshkruajnë Marrëveshjen për të lëshuar Garanci për Marrëveshjet e Huasë së Fondit BESA sh.a. me Bankat e nivelit të dytë

Qëllimi i garancisë është të lehtësojë huadhënien e Fondit BESA sh.a për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, me një fokus të shtuar në sektorin e bujqësisë dhe zonat rurale. Kjo do të kontribuojë në promovimin e rritjes dhe punësimit në Shqipëri, veçanërisht në sektorin e bujqësisë.

Tetor 2019: Festa e Gështenjave

Për të tretin vit radhazi, Fondi Besa merr pjese në panairin e organizuar në Festën e Gështenjës, në Reç të Malësisë Madhe, në mbështetje të

biznesit të vogël dhe të mesëm. Aktiviteti synon të demonstrojë vlerat e agroturizmit në parqet natyrore, nëpërmjet panaireve dhe seancave demonstruese, si dhe promovimin e resurseve të Reçit dhe të përpjekjeve të suksesshme të fermerëve për të ndërtuar bizneset e tyre të vogla si: ambiente për grumbullimin dhe seleksionimin e gështenjës, baxhot e djathit, bujtinat, etj.

Maj 2019: Takim me tregtarë të pajisjeve me eficencë energjie në rrethe të ndryshme, ku u diskutua mbi Kredinë e Gjelbër që Fondi BESA ofron në bashkëpunim me BERZH, nëpërmjet Programit GEFF në Shqipëri, mënyrat e bashkëpunimit me tregtarët dhe procedurat që duhen ndjekur. Kredia e Gjelbër - GEFF" që siguron financim për sektorin e banimit, do të destinohet për individët të cilët dëshirojnë të kryejnë investime në banesën e tyre që synojnë eficencën dhe kursimin e energjisë.

Me kryerjen e investimeve, kreditorët kanë të drejtë të përfitojnë një grant prej 15-20% të vlerës së investimit.

Maj 2019: Fondi Besa, pjesëmarrës në Panairin e Karrierës pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës

Për të tretin vit radhazi Fondi Besa merr pjesë në Panairin e Karrierës pranë UBT, panair i cili është shndërruar në një traditë të suksesshme.

Ky aktivitet përfaqëson një mundësi shumë të mirë ndërveprimi midis universitetit, institucioneve publike, sipërma rrjeve si dhe organizatave të profileve të ndryshme në të gjithë vendin. Ky event krijon mundësi për të përafruar ofertën dhe kërkesën, duke shërbyer kështu si një dritare e rëndësishme komunikimi midis punëdhënësit siç janë institucionet publike, sipërmarrja private dhe organizata të ndryshme dhe punëmarrësit që janë studentët e UBT. Gjithashtu shërben si një mundësi për studentët e UBT, të realizojnë praktikave profesionale pranë institucioneve pjesëmarrëse në panair.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Fondi BESA nënshkruajnë marrëveshje prej 3 milion euro për Kredinë e Gjelbër. Marrëveshja midis BERZH dhe FONDIT BESA synon promovimin e investimeve në ekonominë e gjelbër në banesa në Shqipëri përmes financimit të një shume prej 3 milion Euro për një periudhë 3-vjeçare. Këto investime do të synojnë të përmirësojnë efiçencën e energjisë, do të gjenerojnë kursim të energjisë, do të përmirësojnë komoditetin e jetesës si dhe do të reduktojnë ndotjen e ambientit. Ky produkt tregon edhe një herë kujdesin e Fondit BESA për mjedisin në të cilin ai operon.

Zgjerimi i aktivitetit për të qenë sa më pranë klientëve

Gjatë vitit 2019 Fondi Besa e zgjeroi aktivitetin e tij respektivisht me dy Degë të reja Rajonale përkatësisht në Durrës dhe Tiranë, si dhe dy zyra të reja satelite në Tropojë dhe Delvinë me qëllim rritjen e efektivitetit të institucionit, duke ju përgjigjur në kohë reale kërkesave të klientëve, si dhe për një organizim sa më të mirë të Degëve Rajonale. Me qëllim lehtësimin e shlyerjes së kredisë, Fondi BESA, gjatë vitit 2019, në total ka hapur 11 Zyra Arke, ku nuk aplikohen komisione për klientët që shlyejnë kredinë.

PROJEKTE

Projekti EaSI (Skema e garancisë për Punësim dhe Inovacion Social) - një instrument financiar i mundësuar nga BE për të promovuar punësim të qëndrueshëm, për të garantuar mbrojtjen e duhur sociale, për të luftuar përjashtimin social dhe varfërinë dhe përmirësimin e kushteve të punës. Në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet Fondit BESA dhe Fondit Europian për Investime kjo skemë garancie mbuloi një pjesë të riskut për dy produkte të veçanta për bujqësinë dhe rininë. Deri më 24 Maj 2019, data e mbylljes së projektit, u financuan 1,397 kredi me vlerë 755 milion lekë në sektorin e bujqësisë ose gati 6.2 milion Euro.

Projekti BERZH – AASF (Janar 2017 – Janar 2020): Ky projekt filloi të implementohet në Janar 2017 në përputhje me marrëveshjen e kredisë dhe marrëveshjen e bashkëpunimit për Programin për mbështetjen e Agrobiznesit në Shqipëri të nënshkruar ndërmjet Fondit BESA dhe BERZH-it.

Ky projekt përbëhet nga tre komponentë të lidhur me njeri-tjetrin:

- Kredia (disbursimi i kredisë me vlerë 5 milion Euro që BERZH i ka akorduar Fondit BESA.
- Programi për bashkëpunim teknik, ku përfshihen trajnime të ndryshme dhe ngritje kapacitetesh.
- Një skemë garancie e mbështetur në fondet "grant" të cilat do të akordohen nga Qeveria Shqiptare.

Në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit, gjatë vitit 2019 ka vazhduar implementimi i programit për ngritjen e kapaciteteve, ne kuadër të të cilit janë organizuar trajnime me fokus sektorin bujqësor dhe kryesisht mbi kartat teknologjike në degët Korçë, Lushnjë, Fier dhe Shkodër.

Projekti CESVI – Fondi Besa (Turizmi): Projekti "*Shqipëri, Udhëto në Mënyrën Tënde: Menaxhimi Multi-aktor i Integruar i Turizmit Rural dhe Kulturor në Qarqet Gjirokastër dhe Berat* (TREC), është projekt i bashkë-financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS), konkretisht komponenti Aksesi në financime për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve në përmirësimin e sistemit të turizmit në fushat përkatëse në bashkitë Gjirokastër, Përmet, Berat e Skrapar.

Projekti "Zana e Maleve": projekt i financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS). Qëllimi i projekti të ri të quajtur "Zana e Maleve" është të kontribuojë në promovimin e një modeli ekonomik dhe social të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës në veriun e Shqipërisë, përkatësisht në zonën e Malësisë së Madhe. **Projekti synon kreditimin e** aktiviteteve bujqësore dhe në sektorin e turizmit, bizneseve start-up, kreditimit e të rinjve dhe grave në biznes **në Malësi të Madhe me kushte favorizuese.**

Vlera e këtij projekti është financuar 50% nga fondet e Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim dhe 50% nga Fondi BESA dhe në përfundim të projektit, shuma **e financuar nga Kooperacioni Italian** do të kalojë në formë granti në llogari të Fondit BESA sh.a.

Në kuadër të këtij projekti, gjithashtu, gjatë vitit 2019 u organizua një trajnim i të rinjve të zonës së Malësisë së Madhe në lidhje me krijimin e bizneseve start-up.

SME Projekt

Kredia "**Besa SME Projekt**" është një produkt kredie në kuadër të Marrëveshjes së Kredisë dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në Fondin e Garancisë nënshkruar ndërmjet Fondit BESA dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për programin **Për Zhvillimin e Sektorit Privat, përmes mbështetjes së SME-ve dhe asistencës teknike – PRODAPS.** Këto programe janë financuar nga Qeveria Italiane përmes Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS).

Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, u dizenjua produkti i kredisë "**Besa SME Projekt**" i cili në thelb ka financimin e bizneseve që ushtrojnë aktivitet në sektorë të ndryshëm apo personat të cilët duan të hapin një aktivitet start-up.

GEFF

Projekti GEFF – Green Energy Financing Facility, në kuadër të marrëveshjes së kredisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Fondit Besa dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, synon promovimin e investimeve në ekonominë e gjelbër në banesa në Shqipëri. Kjo marrëveshje bashkëpunimi mbështetet gjithashtu me një shumë grant të financuar nga Fondi Europian i Përbashkët i Ballkanit Perëndimor për aplikimin e skemës nxitëse për huamarrësit që kryejnë këto investime si dhe nga Qeveria Austriake dhe fondi në kuadër të Investimeve në Ballkanin Perëndimor për financimin e programit për Bashkëpunimin Teknik për këtë marrëveshje.

Në përputhje me specifikimet e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Fondit BESA dhe BERZH u dizenjua produkti "Kredi e Gjelbër - GEFF".

"Kredia e Gjelbër - GEFF" destinohet për individët të cilët dëshirojnë dhe kanë të drejtë ligjore të kryejnë investime në banesën e tyre që synojnë eficencën dhe kursimin e energjisë.

Për çdo investim të kryer nga klienti në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e këtij projekti, klienti do të përfitojë në formë **granti 15 – 20%** të vlerës së investimit, nëse investimi është i barabartë me shumën e kredisë ose vlerës së kredisë në rast se investimi është më i madh.

Përveç punës për ndërtimin e infrastrukturës për implementimin e këtij projekti dhe produktit specifik të kredisë, Departamenti i Marketingut është angazhuar në trajnimin e degëve të institucionit në lidhje me këtë produkt kredie dhe mënyrën se si do të funksionojë projekti. Në muajin Mars 2019 u zhvillua një fushatë marketingu në kuadër të këtij projekti.

Raporti i auditorëve të pavarur

Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
NUIS: K61911012I
Ibrahim Rugova Str. Sky Tower,6th floor
1001 Tirana Albania

Tel: +35542419575
ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Fondi Besa sh.a

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Fondi Besa sh.a (më poshtë "Grupi"), që përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2019, dhe pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara të Fondi Besa sh.a paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të konsoliduar të Grupit më 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare të konsoliduar dhe flukset monetare të konsoliduara për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Grupi në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi i BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri ("Kodi IEKA"), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të Tjera të Përfshira në Raportin Vjetor 2019 të Fondi Besa sh.a.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Grupit për vitin 2019, përgatitur ne përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Grupit për vitin 2019 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe te vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare të konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare të konsoliduara (vazhdim)

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e proçesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare të konsoliduara, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë proçedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë proçedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Grupit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Grupit për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare të konsoliduara, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Grupi të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.
- Marrja e evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit në lidhje me informacionin financiar të subjekteve ose aktivitetet e biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe kryerjen e auditimit në nivel grupi. Ne mbetemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Fondi Besa sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojme gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri
Ernst & Young Certified Auditors
28 dhjetor 2020
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel
Auditues Ligjor

Struktura Organizative



Histori suksesi

Klientja: Kushdo do të zgjidhte Fondin Besa për kushtet që ofron dhe shpejtësinë në miratimin e kredisë

Me mbi 18 vite në treg, me një histori të mbushur me profesionalizëm, përgjegjshmëri dhe vullnet, Nesrete Fisniku është sot një sipërmarrëse e suksesshme në fushën e farmacisë. E nisi aktivitetin e biznesit para gati 2 dekadave dhe tani, me përkushtim ia doli që të menaxhojë e vetme 2 farmaci, në qytetin e Tiranës.

"Kur vendosa të hap farmacinë e dytë u ndesha me një konkurrencë shumë të fortë. Falë kredisë së përfituar nga Fondi Besa zgjerova aktivitetin, duke përfituar dhe shtimin e klientelës", tregon e kënaqur klientja e Fondit Besa.

Oficerja e kredisë, Inesi, e cila falë angazhimit maksimal bëri të mundur që kredia të përfitohej shumë shpejt, thotë se, Nesreti ka shfaqur korrektesë, duke paguar gjithmonë në datën e caktuar këstin e kredisë.

"Falënderoj përzemërsisht oficeren e kredisë për ndihmën. Jo vetëm unë, por kushdo që do të përfitojë financim do të zgjidhte Fondin Besa, pasi klienti nuk paguan komision për shlyerje të parakohshme të kredisë", përfundon Nesrete Fisniku.

Histori suksesi

Fondi Besa, zgjidhje në momente të vështira!

Rruga drejt suksesit të biznesit është vazhdimisht në ndërtim e sipër. “Luara” është një ndër bizneset më të njohura në fushën e pastiçerisë, e cila u zhvillua edhe më tej, me ambiente moderne, falë kredisë së përfituar nga Fondi Besa. Pronari i këtij biznesi, Fatmir Pashollari, që të gjithë e njohin si mjeshtrin e bukës dhe pastiçerisë shprehet se, Fondi Besa e ka ndihmuar atë në momente të vështira.

“Në fillim u ndjeva i demoralizuar, pasi nuk gjeja mbështetje financiare për të zhvilluar biznesin tim, por nuk hoqa dorë. Pa hezitim shkova në zyrat e Fondit Besa dhe kërkova ndihmën e tyre për të investuar në degën më të re të pastiçerisë, në sheshin Avni Rustemi”, tregon pronari i biznesit.

Ai shpjegon më tej se, nuk e kishte menduar se do të përfitonte nga Fondi Besa një Kredi Biznesi prej 278,000 euro, që më pas e ndihmoi atë të ishte aq i suksesshëm sa është sot.

“Kam besuar gjithmonë në sukses, por kurrë nuk kam menduar se do të arrija kaq lart. Me vendosmëri absolute dhe mbështetjen e Fondit Besa, mposhta barrierat”, përfundon ai.

Sot “Luara” ushtron aktivitetin e saj në tre degë në qytetin e Tiranës. Fatmir Pashollari karakterizohet nga thjeshtësia, modestia dhe bujaria. Ai së bashku me familjen e tij janë të përfshirë në biznes, duke dëshmuar kështu një shembull të vërtetë të sipërmarrjes private në vendin tonë.

Është mirë të festosh suksesin!

Partneret

BIB
FAIR BANKING

CoopEst
finance for social economy | initiatives in central eastern europe

Frankfurt School
of Finance & Management
German Excellence. Global Relevance.

ALBANIAN BESA CAPITAL
Fondacioni ABC

Raiffeisen BANK

BKT
BANKA KOMBETARE TREGTARE

otpbank

TIRANA BANK

Fondi BESA sh.a.
Rruga: “Brigada VIII”, Pallati Nr. 5
(zona e ish-Bllokut), Tiranë - Shqipëri
Tel: 04 2253841/2 Fax: 04 2253836
E-mail: mfi@besa.org.al www.fondibesa.com